



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 07 Prot

Kamëz, më 10.02.2021

V E N D I M

Nr. 06 Datë 10.02.2021

M B I

**“VENDOSJEN E TARIFES USHQIMORE TË FËMIJËVE NË KOPSHTE DHE  
ÇERDHE ME USHQIM DHE SHËRBBIMIN PA PAGESË PËR FAMILJET NË  
NEVOJË”**

**Këshilli Bashkiak Kamëz** i mbledhur sot më **10.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.07 Datë 05.02.2021** , në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 **“PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”**, neni 8, 9/1.1, 23/12, 29, 54 ; ligjin nr. 69/2012 ‘ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’ neni 1,2/1, 6/6, 28/4/a ; ligjin nr. 121/2016 ‘Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë’ neni 25/1 ; **Këshilli Bashkiak Kamëz :**

V E N D O S I :

**1. Të miratojë vendosjen e tarifës ushqimore për fëmijët në kopshte dhe çerdhe me ushqim dhe shërbimin pa pagesë për fëmijët në nevojë, si më poshtë:**

**A. Tarifa për kopshtet dhe çerdhet**

**1.** Fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet në Bashkinë Kamëz, paguajnë një tarifë ditore:

- a. 160 lekë për fëmijë në kopshte;
- b. 130 lekë për fëmijë në çerdhe.
- c.

**2. Përlllogaritja e detyrimit:**

- a. Detyrimi mujor përbëhet nga tarifa për ushqimin, e cila përlllogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe apo kopsht gjatë një muaji.
- b. Për fëmijët e rregjistruar për herë të parë në kopsht, kryhet një pagesë paraprake në shumën prej 5 000 lekë, në formën e garancisë. Për fëmijët e rregjistruar për herë të parë në çerdhe, kryhet një pagesë

paraprake në shumën prej 3 500 lekë, në formën e garancisë. Kjo shumë i rikthehet familjeve me perfundimin e periudhës së trajtimit në këto institucione dhe pasi janë kryer verifikimet së nuk kanë detyrime të papaguara.

**B. Shërbimi pa pagesë për fëmijët në nevojë**

1. Përfitojnë shërbimin pa pagesë familjet në nevojë me përbërje:
  - a. Fëmijë me statusin e jetimit.
  - b. Fëmijet e komunitetit rom/egjiptian.
  - c. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit.
  - d. Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.
  - e. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike apo me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.
  - f. Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Nën/Kryetar Këshilli**

